FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

VITAMINE D2

Tretësirë për injeksion - 300 000 UI / 1 ml
(Ergokalçiferol)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Vitamine D2 dhe përse përdoret?
2. Përpara se të merrni Vitamine D2
3. Si ta merrni Vitamine D2?
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Vitamine D2?
6. Informacion i mëtejshëm.

1. ÇFARË ËSHTË VITAMINE D2 DHE PËRSE PËRDORET?

Vitamina D bën pjesë në grupin e vitaminave të tretshme në yndyrna. Me termin vitaminë D kuptohet një varg përbërjesh sterolike të ngjashme që kanë veti të parandalojnë ose të mjekojnë rakitin. Burimet natyrore të vitaminës D për organizmin e njeriut varen nga rrezatimi ultravjollcë (UV), i cili e shndërron 7-dehidrokolesterolin (provitamina D) në kolekalçiferol (vitamina D3) ose ergosterolin në ergokalçiferol (vitamina D2).
Pamjaftueshmëria e vitaminës D shfaqet kur nuk bëhet një ekspozim i mirë në dritën e diellit ose nga pamjaftueshmëria e kësaj vitamine në ushqim.
Pamjaftueshmëria e vitaminës D shkakton rakitin tek fëmijët dhe osteomalacinë tek të rriturit.

Indikimet janë:
- parandalim dhe mjekim i pamjaftueshmërisë së vitaminës D si rezultat i mungesës së futjes së kësaj vitamine në organizëm dhe nga ulja e sintezës së saj (dietë e njëanshme dhe pa yndyrna, mungesë ekspozimi në diell, çrregullim i përthithjes së saj nga zorrët);
- parandalim dhe mjekim i rakitit e osteomalacisë;
- spazmofilitë e fëmijëve dhe në tetanitë.

Mjeku juaj mund ta ketë dhënë Vitamine D2 për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini pse ju është dhënë ky bar.

2. PËRPARA SE TË MERRNI VITAMINE D2

Mos përdorni Vitamine D2 në qoftë se keni:
- mbindjeshmëri ndaj ergokalçiferolit ose etil oleatit;
- nefrit;
- litiazë renale;
- proçese degjenerative kardiovaskulare;
- hiperkalçemi;
- kalçifikim metastazik.

Në qoftë se mendoni se keni gjendjet e përmendura më sipër, këshillohuni fillimisht me mjekun tuaj dhe ndiqni këshillat e dhëna.

Tregoni kujdes të veçantë me Vitamine D2
Vitamina D duhet përdorur me kujdes tek pacientët me funksion renal të dëmtuar, me kalkula renale dhe tek ata me sëmundje kardiake, sepse nëse ndodh hiperkalçemia, këta pacientë janë më të riskuar për dëmtim të organeve.
Gjatë trajtimit me vitaminë D duhen kontrolluar përqëndrimet plazmatike të fosfateve për të reduktuar riskun e kalçifikimit ektopik.
Këshillohet që pacientët të cilët marrin doza farmakologjike të vitaminës D të kontrollojnë rregullisht nivelet e kalçiumit në plazëm, kryesisht në fillim të trajtimit dhe nëse shfaqen simptomat e toksicitetit.
Këshillohet që nënat të cilat marrin doza farmakologjike të vitaminës D, të mos i ushqejnë foshnjet me gji, sepse atyre mund t'u shfaqet hiperkalçemi.
Vitamina D duhet përdorur me kujdes në foshnjet sepse janë të ndjeshme ndaj efekteve të saj.
Toleranca ndaj vitaminës D varion ndjeshëm ndërmjet personave; foshnjet dhe fëmijët janë më të ndjeshëm ndaj efekteve të saj toksike.
Diferenca mes përqëndrimit terapeutik dhe atij toksik është e vogël, ndaj duhet treguar kujdes në marrjen e kësaj vitamine.

Marrja e barnave të tjera
- Kur vitamina D përdoret njëherësh me diuretikët tiazidikë, kalçiumin ose fosfatet, ekziston rreziku i hiperkalçemisë. Në këtë rast, duhen mbikqyrur përqëndrimet plazmatike të kalçiumit të të sëmurit.
- Disa antiepileptikë mund t'i shtojnë kërkesat për vitaminë D (p.sh. karbamazepina, fenobarbitali, fenitoina dhe primidoni).
- Rifampicina dhe izoniazidi mund të reduktojnë efikasitetin e vitaminës D.
- Kortikosteroidet mund të antagonizojnë efektin e vitaminës D.

Kërkoni këshillën e mjekut ose të farmacistit nëse njëkohësisht me Vitamine D2 merrni edhe barnat e përmendura më sipër.

Marrja e Vitamine D2 me ushqim dhe pije
Nuk aplikohet.

Shtatzënia
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë dhe këshillohuni me të për përdorimin e këtij bari gjatë shtatzënisë:
Hiperkalçemia gjatë shtatzënisë mund të shkaktojë shqetësime kongenitale tek fetusi dhe hipoparatiroidizëm tek i porsalinduri.
Këshillohet shmangia e përdorimit gjatë shtatzënisë.

Ushqimi me gji
Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjen me qumësht gjiri dhe këshillohuni me të për përdorimin e këtij bari gjatë kësaj periudhe.
Vitamina D kalon në qumështin e gjirit.
Këshillohet që nënat të cilat marrin doza farmakologjike të vitaminës D, të mos i ushqejnë foshnjet me gji, sepse atyre mund t'u shfaqet hiperkalçemi.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Nuk ka të dhëna.

3. SI TA MERRNI VITAMINE D2?

Fëmijët, për profilaksinë e rakitit, me injektim në muskul: 1 ml (300 000 UI), dozë që mund të përsëritet pas 3 – 5 javësh.
Për mjekimin e rakitit: 1 ml (300 000 UI), dozë që mund të përsëritet pas 3 – 5 javësh.
Dozat më të larta janë të përshtatshme për tu përdorur në shenjat e rakitit të rëndë, si edhe kur fëmija preket nga sëmundje të rënda akute (pneumoni, sëmundje me ethe).
Në raste tetanie në fëmijët, si rezultat i rakitit, është e nevojshme që vitamina D2 të kombinohet edhe me përdorimin e kalçiumit.
Në rastet e tetanisë nga hipoparatireoza primare në të rriturit, injektohen doza deri në 400 000 UI (10 mg) në ditë, për ditët e para, së bashku me marrjen e kalçiumit nga goja.

Në qoftë se keni marrë më shumë Vitamine D2
Në qoftë se keni marrë më shumë Vitamine D2 se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

Në qoftë se keni harruar të merrni Vitamine D2
Në qoftë se harroni një dozë, merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar!
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore.
Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo.
Marrja e tepërt e vitaminës D çon në zhvillimin e hiperkalçemisë ose të hiperfosfatemisë. Efektet që shoqërojnë hiperkalçeminë janë: hiperkalçiuri, kalçifikim ektopik dhe dëmtim renal dhe kardiovaskular.
Simptomat e mbidozimit përfshijnë: anoreksi, këputje, të përziera dhe të vjella, konstipacion ose diarre, poliuri, nokturi, djersitje, dhimbje koke, etje, përgjumje dhe marrje mendsh.
Kanë ndodhur edhe reaksione mbindjeshmërie.
Nëse shfaqet toksicitet, vitamina duhet ndërprerë.
Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore të përmendura më sipër ju shqetëson.
Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI VITAMINE D2?

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Vitamine D2 pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim.
Të ruhet nën 25°C!
Ruajeni në vende të thata e pa dritë!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Vitamine D2
Lënda vepruese është ergokalçiferol.
Çdo ampulë 1 ml përmban 300 000 UI (NJ.N) ergokalçiferol.
Përbërësit e tjerë: etil oleat.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 10 ampula, kuti me 100 ampula (për përdorim spitalor).

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Sipas recetës së mjekut.
Përmbajtja. Kujdes.
Tretësirë për injeksion.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Dhjetor 2012.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.